

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **614-26-3929-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim në Institucione Publike Komunale**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Best D.D.D. SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Vellezerit Gervalla

(Adresa)

Ferizaj

70000

(Vendi)

(Kodi postar)

049851805

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Florian Syla

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Floriansyla23@gmail.com

(Adresa elektronike)

10.07.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftim per Kontrat 03.06.2026 00:00

B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve (45).pdf 15.06.2026 10:41

B58 Njoftim për vendimin e AK.pdf24.06.2026 10:12

KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTE - Best D.D.D. SH.P.K..pdf 25.06.2026 09:38

Lejim ne qasjen e kerkuar 25.06.2026 11:48

Kerkese per rishqyrtim 28.06.2026 14:00

Vendim ne kerkesen per rishqyrtim (1).pdf 02.07.2026 15:10

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Hapja e ofertave është bërë përmes platformës së E-prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 24.06.2026, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal i Obiliqit, me datë 28.06.2026.

Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal i Obiliqit, me datë 02.07.2026, na ka njoftuar me Vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar dhe ka lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – B58, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim në Institucione Publike Komunale”, me nr. të prokurimit 614-26-3929-2-2-1.

Bazuar në dispozitat e nenit 109 të LPP-së, parashtrojmë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit kundër Vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – B58, si dhe kundër letrës standarde si operator ekonomik i pasuksesshëm.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit

Neni 1 – Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi

Neni 28 - Specifikimet Teknike

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne, Operatori Ekonomik ankues Best D.D.D. SH.P.K., kemi marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit me titull “Dezinfektim, Deratizim, Dezinsektim në Institucione Publike Komunale”, me nr. të prokurimit 614-26-3929-2-2-1, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal i Obiliqit.

Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me datë 24.06.2026, dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, kemi konstatuar se vlerësimi i ofertave nuk është bërë në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat përkatëse të LPP-së. Për këtë arsye, me datë 28.06.2026, kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim dhe ka lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e AK-së – B58. Konsiderojmë se ky vendim është i pabazuar dhe nuk i trajton drejt faktet, argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga ana jonë.

Për rrjedhojë, përmes kësaj ankese kundërshtojmë Vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ndërsa në vazhdim do t'i paraqesim në mënyrë të detajuar bazat, faktet dhe argumentet që mbështesin ankesën tonë :

Pretendimi 1.

Mospërmbushja e kërkesës për stafin teknik nga OE i rekomanduar për kontratë

Në kuadër të kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional, Dosja e Tenderit ka kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt, përkatësisht minimum pesë (5) punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e projektit. Po ashtu, si dëshmi është kërkuar lista e stafit, e cila duhet të përmbajë emrin, mbiemrin, profesionin dhe pozicionin e angazhuar në kompani.

OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar vetëm një listë me emra të personave, mirëpo nuk ka ofruar asnjë dëshmi se personat e paraqitur në atë listë janë aktualisht të punësuar, të

angazhuar apo në dispozicion të kompanisë për realizimin e këtij projekti. Lista e stafit, pa kontrata pune, parakontrata, marrëveshje angazhimi, dëshmi të kontributeve/pagave, dëshmi nga ATK/Trusti apo ndonjë dokument tjetër mbështetës, nuk dëshmon realisht se këta persona janë pjesë e stafit të OE-së apo se do të jenë në dispozicion për ekzekutimin e kontratës.

Dëshmia nr. 1 – Lista e stafit e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë

LISTA E STAFIT TE KOMPANISË

Nr.	Emri dhe mbiemri	Profesioni	Pozicioni i angazhuar ne kompani
1	Ismail Bektashi	Epidemiolog	Epidemiolog
2	Besim Zejnullahu	Doktor i Shkencave Agronomike	Menaxher i projekteve DDD
3	Ali Shaqiri	Teknik i lartë sanitar	Teknik sanitar dhe teknik për DDD
4	Rexhep Zejnullahu	Shkollim i mesëm	Teknik i DDD-së
5	Samete Luzha	Shkollim i mesëm	Teknik i DDD-së
6	Arbes Zejnullahu	Shkollim i mesëm	Teknik i DDD-së
7	Shkelzen Haliti	Shkollim i mesëm	Teknik i DDD-së

BESIM A.ZEJNULLAHU B.I
N.SH."EKO-DDD"
Ferizaj

15.06.2026

Siç shihet nga lista e stafit e dorëzuar nga OE i rekomanduar, janë paraqitur vetëm emrat e personave/stafit, mirëpo nuk është bashkëngjitur asnjë dëshmi mbështetëse që vërteton se këta persona janë të punësuar, të angazhuar apo në dispozicion të OE-së për realizimin e këtij projekti.

Kërkesa e Dosjes së Tenderit nuk ka qenë vetëm paraqitja formale e disa emrave në një listë, por dëshmimi i stafit të nevojshëm që është i angazhuar në kompani dhe që do të përdoret për realizimin e projektit. Vetë fakti që në Dosje të Tenderit kërkohet të shënohet “pozicioni i angazhuar në kompani” tregon se duhet të ekzistojë një lidhje reale juridike/profesionale ndërmjet OE-së dhe personave të listuar, e jo vetëm paraqitje deklarative e emrave.

Në këtë mënyrë, lista e dorëzuar nga OE i rekomanduar ka karakter thjesht deklarativ dhe nuk mund të trajtohet si dëshmi objektive për përmbushjen e kërkesës. Nëse një listë e tillë pranohet pa asnjë dokument mbështetës, atëherë çdo operator ekonomik do të mund të shkruante emra të personave pa dëshmuar se ata janë të punësuar, të kontraktuar apo të angazhuar realisht, dhe në këtë mënyrë kriteri për staf teknik do ta humbte plotësisht kuptimin.

Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderit të verifikojë nëse stafi i deklaruar nga OE i rekomanduar ekziston realisht si kapacitet teknik i kompanisë. Ky verifikim do të mund të bëhej përmes kontratave të punës, parakontratave, marrëveshjeve të angazhimit, dëshmime mbi pagat dhe kontributet, dëshmime nga ATK/Trusti apo dokumenteve të tjera objektive që vërtetojnë lidhjen e stafit me operatorin ekonomik.

Në këtë rast nuk po kontestohet vetëm forma e listës së stafit, por mungesa e plotë e dëshmisë se kapaciteti teknik i deklaruar ekziston realisht. OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar se personat e listuar janë të punësuar, të angazhuar apo në dispozicion të tij për ekzekutimin e kontratës. Rrjedhimisht, nuk është dëshmuar përmbushja reale e kërkesës për minimum pesë (5) punëtorë të nevojshëm për kryerjen e projektit.

Kjo çështje është edhe më e rëndësishme për faktin se kemi të bëjmë me shërbime të Dezinfektimit, Deratizimit dhe Dezinsektimit në institucione publike, ku angazhimi i stafit real dhe të disponueshëm është i domosdoshëm për ekzekutim të sigurt, profesional dhe në përputhje me kërkesat e kontratës. Pranimi i një liste formale pa dëshmi mbështetëse nuk garanton kapacitetin real të OE-së për realizimin e këtyre shërbimeve.

Autoriteti Kontraktues, duke e shpallur të përgjegjshëm OE-në e rekomanduar pa verifikuar nëse stafi i deklaruar është realisht i angazhuar në kompani, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Kriteret e njëjta të Dosjes së Tenderit duhet të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, pa favorizuar OE-në e rekomanduar duke pranuar deklarime formale pa prova konkrete.

Po ashtu, nëse OE i rekomanduar do të lejohej të dorëzonte më vonë dokumente të reja për të dëshmuar angazhimin e stafit, atëherë kjo do të përbënte plotësim të ofertës pas afatit të dorëzimit dhe jo vetëm sqarim të dokumenteve ekzistuese. Dokumentet që dëshmojnë stafin duhet të kenë ekzistuar dhe të jenë dorëzuar si pjesë e ofertës, ose së paku ekzistenca e tyre të jetë e verifikueshme në mënyrë objektive para afatit për dorëzimin e tenderëve.

Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta rishqyrtojë vlerësimin e bërë dhe ta konstatojë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesës për stafin teknik. Si pasojë, oferta e tij nuk mund të konsiderohet e përgjegjshme dhe duhet të rivlerësohet në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e LPP-së.

Qëndrimi i Autoritetit Kontraktues dhe kundërshtimi i OE ankues lidhur me Pretendimin nr. 1

Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen e tij ndaj Pretendimit nr. 1, ka arsyetuar se kërkesa jonë është e pabazuar, meqenëse Dosja e Tenderit ka kërkuar vetëm dorëzimin e listës së stafit dhe nuk ka paraparë shprehimisht kontrata pune, dëshmi nga ATK-ja, Trusti apo dokumente të tjera mbështetëse. AK-ja, rrjedhimisht, ka konsideruar se kërkimi apo vlerësimi i dokumenteve të tilla do të përbënte vendosje të një kriteri të ri pas afatit për dorëzimin e tenderëve dhe do të ishte në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Ky arsyetim nuk e trajton drejt thelbin e pretendimit tonë. Ne nuk kemi kërkuar vendosjen e kriterëve të reja dhe as plotësimin e ofertës me dokumente që nuk janë kërkuar në Dosjen e Tenderit. Kundërshtimi ynë lidhet me faktin se AK-ja e ka pranuar listën e stafit vetëm në aspektin formal, pa verifikuar nëse personat e paraqitur në të janë realisht të angazhuar, në dispozicion të operatorit ekonomik dhe të gatshëm për realizimin e kontratës.

Për këtë arsye, ndaj arsyetimit të Autoritetit Kontraktues paraqesim kundërshtimin në vijim:

Kundërshtim ndaj përgjigjes së Autoritetit Kontraktues për Pretendimin nr. 1

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues se pretendimi ynë është i pabazuar, vetëm për faktin se Dosja e Tenderit ka përcaktuar si dëshmi “listën e stafit” dhe nuk ka kërkuar shprehimisht

kontrata pune, dëshmi nga ATK-ja apo Trusti, përbën interpretim të ngushtë dhe formal të kërkesës së Dosjes së Tenderit dhe zbatim të gabuar të nenit 59 të LPP-së.

Ne nuk pretendojmë që Autoriteti Kontraktues, pas hapjes së ofertave, të vendosë një kriter të ri ose të kërkojë nga OE i rekomanduar dokumente që nuk kanë qenë të parashikuara në Dosjen e Tenderit. Pretendimi ynë është se AK-ja ka pasur detyrim të verifikojë nëse përmbajtja e listës së dorëzuar dëshmon realisht përmbushjen e kriterit të përcaktuar, përkatësisht ekzistencën dhe disponueshmërinë e minimum pesë punëtorëve që **“do të angazhohen në këtë projekt”** dhe pozitën e tyre **“të angazhuar në kompani”**. Dosja nuk ka kërkuar thjesht një tabelë me pesë emra, por paraqitjen e stafit që do të jetë realisht në dispozicion për ekzekutimin e kontratës.

Lista e hartuar, nënshkruar dhe vulosur në mënyrë të njëanshme nga vetë OE-ja nuk mund të trajtohet automatikisht si dëshmi përfundimtare se personat e shënuar në të janë të punësuar, kanë pranuar angazhimin ose do të jenë në dispozicion për realizimin e kontratës. Një listë e tillë përmban vetëm deklarinimin e operatorit ekonomik, por nuk krijon vetvetiu lidhje juridike apo faktike ndërmjet operatorit dhe personave të listuar.

Zbatimi i gabuar i nenit 59 të LPP-së

AK-ja ka konstatuar se kërkimi i kontratave të punës, dëshmive nga ATK-ja, Trusti apo dokumenteve të tjera do të ishte në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së. Ky përfundim nuk qëndron.

Neni 59.4 i LPP-së përcakton se një tender mund të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm kur është në përputhje me të gjitha kërkesat e Njoftimit për Kontratë dhe të Dosjes së Tenderit. Prandaj, detyra e Komisionit Vlerësues nuk përfundon me konstatimin se dokumenti i titulluar “Lista e stafit” është ngarkuar në platformë. Komisioni duhet të shqyrtojë nëse përmbajtja e tij dëshmon në mënyrë të arsyeshme dhe objektive përmbushjen e kërkesës materiale për stafin që do të angazhohet në projekt.

Duhet bërë dallim i qartë ndërmjet:

- vendosjes së një kriteri ose dëshmie të re pas afatit të dorëzimit të tenderëve; dhe
- verifikimit të vërtetësisë, përmbajtjes dhe besueshmërisë së informatave të paraqitura në një dokument të dorëzuar.

E para nuk lejohet, ndërsa e dyta është pjesë përbërëse e ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderit sipas nenit 59 të LPP-së. Autoriteti Kontraktues nuk mund ta përdorë nenin 59 si bazë për të mos verifikuar fare nëse kapaciteti njerëzor i deklaruar ekziston realisht.

Në rast se AK-ja kishte paqartësi lidhur me statusin apo disponueshmërinë e personave të paraqitur në listë, ai mund të kërkonte sqarim të informatave ekzistuese, pa lejuar ndryshimin material të ofertës dhe pa lejuar krijimin e kapaciteteve të reja pas afatit të dorëzimit. Një sqarim i tillë do të duhej të kufizohej në vërtetimin e një gjendjeje që ka ekzistuar para përfundimit të afatit për dorëzimin e tenderëve. Nëse angazhimi nuk ka ekzistuar deri në atë moment, ai nuk mund të krijohet më vonë përmes dokumenteve të reja.

Moszbatimi i neneve 67 dhe 69 të LPP-së

Sipas nenit 69.1 të LPP-së, operatorët ekonomikë duhet të sigurojnë dëshmi që tregojnë se i posedojnë kualifikimet minimale teknike dhe profesionale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Për kontratat e shërbimeve, neni 69.4 lejon që aftësia të vlerësohet në bazë të të

dhënave që dëshmojnë shkathtësinë, kapacitetin, përvojën, efikasitetin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik. Kjo do të thotë se kapaciteti nuk duhet vetëm të deklarohet, por duhet të ekzistojë dhe të jetë i disponueshëm për realizimin e shërbimeve.

Gjithashtu, neni 67.2 i LPP-së kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik kur nuk paraqiten prova të mjaftueshme që tregojnë në mënyrë të arsyeshme se ai i përmbush kushtet minimale teknike dhe profesionale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Në këtë rast, çështja nuk është se OE-ja nuk ka dorëzuar një dokument me titullin e kërkuar, por se dokumenti i dorëzuar nuk ofron siguri objektive se personat e listuar përbëjnë kapacitet real dhe të disponueshëm të operatorit.

Shkelja e parimit të trajtimit të barabartë

Pranimi automatik i një liste të njëanshme, pa kontrolluar nëse personat e deklaruar janë realisht të angazhuar apo në dispozicion, cenon edhe parimin e trajtimit të barabartë dhe të mosdiskriminimit sipas nenit 7 të LPP-së. Vlerësimi duhet të mbështetet në kritere objektive dhe të verifikueshme dhe jo vetëm në formën apo emërtimin e dokumentit.

Nëse do të pranohej interpretimi i AK-së, çdo operator ekonomik do të mund të shënonte në një listë emrat e personave të tretë, pa dijeninë ose pëlqimin e tyre, dhe vetëm me vulën e vet të pretendonte se e ka përmbushur kërkesën për kapacitet njerëzor. Një praktikë e tillë do ta kthente kriterin për staf në formalitet pa vlerë verifikuese dhe do ta pamundësonte vlerësimin real të aftësisë teknike dhe profesionale.

Për më tepër, Dosja e Tenderit përdor shprehimisht formulimet “**stafi i nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt**” dhe “**pozicioni i angazhuar në kompani**”. Shprehja “i angazhuar” nënkupton një marrëdhënie reale ose së paku një zotim konkret për angazhim, dhe jo vetëm përfshirjen nominale të një personi në një listë.

Përfundim

Rrjedhimisht, AK-ja gabimisht e ka reduktuar pretendimin tonë në kërkesë për vendosjen e dokumenteve të reja, ndonëse pretendimi lidhet me mungesën e dëshmisë së mjaftueshme dhe me mosverifikimin e kapacitetit real të OE-së së rekomanduar.

Neni 59 i LPP-së nuk e ndalon verifikimin e informatave të paraqitura; përkundrazi, e obligon AK-në që ta konsiderojë tenderin të përgjegjshëm vetëm pasi të konstatojë përputhshmërinë reale me të gjitha kërkesat e Dosjes së Tenderit. Duke e pranuar listën vetëm mbi bazën e ekzistencës formale të saj, pa vlerësuar nëse personat e listuar janë realisht të angazhuar dhe në dispozicion, AK-ja nuk ka bërë ekzaminim të plotë në kuptim të nenit 59, nuk ka zbatuar drejt nenet 67 dhe 69 dhe nuk ka siguruar vlerësim objektiv e të barabartë sipas nenit 7 të LPP-së.

Prandaj, përgjigjja e AK-së ndaj Pretendimit nr. 1 duhet të refuzohet si juridikisht e paqëndrueshme, ndërsa OSHP-ja duhet të urdhërojë rivlerësimin e ofertës së OE-së së rekomanduar dhe verifikimin objektiv të faktit nëse personat e paraqitur në listën e stafit kanë qenë realisht të angazhuar dhe në dispozicion të operatorit ekonomik para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve.

Pretendimi 2.

Mospërmbushja e kërkesës për pajisje – paraqitja e pajisjes “Automizer multifunksional elektrostatik” si “Gjenerator ULV”

Në kuadër të kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional, Dosja e Tenderit ka kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë pajisjet për realizimin e projektit, ndër të tjera edhe dy (2) gjeneratorë ULV. Kjo kërkesë është kërkesë e qartë, e matshme dhe e detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

OE i rekomanduar për kontratë, në listën e mjeteve/pajisjeve të punës, ka paraqitur pajisjen me emërtimin: “Gjenerator ULV – Automizer multifunksional elektrostatische për dezinfektim hapësinor (me qera)”. Mirëpo, nga dokumentet mbështetëse të dorëzuara nga vetë OE i rekomanduar rezulton se kjo pajisje nuk është dëshmuar si gjenerator ULV, por si “Automizer multifunksional elektrostatik për dezinfektim hapësinor”.

Dëshmia nr. 2 – Lista e mjeteve të punës e dorëzuar nga OE i rekomanduar:

LISTA E MJETEVE TË PUNËS

Nr	Lloji i pajisjes	Sasia
1	Gjenerator ULV – MMT Hunter Mist Blower 35HP	1
2	Gjenerator ULV – Automizer multifunksional elektrostatische per dezinfektim hapësinor (me qera)	1
3	Spërkatëse motorike DM-14 PE, DM-14P, SR-420	6
4	ULV elektrostatische- VP 200ES Electrostatic	2
5	Kamioneta për vendosjen e këtyre makinave (me qera)	2
6	Makinë për bartjen e punëtorëve (Nissan Navara dhe Opel Combo Life)	2

BESIM A.ZEJNULLAHU B.I.
N.SH.”EKO-DDD”
Ferizaj

Data: 15.06.2028



Siç shihet nga lista e mjeteve të punës, OE i rekomanduar ka vendosur para emërimit të pajisjes termin “Gjenerator ULV”, mirëpo ky emërtim nuk përputhet me dokumentet tjera të dorëzuara si dëshmi për këtë pajisje. Në faturën e blerjes dhe në kontratën e qirasë, pajisja nuk paraqitet si gjenerator ULV, por si automizer multifunksional elektrostatik për dezinfektim hapësinor.

Dëshmia nr. 3 – Kontrata për shfrytëzimin e pajisjes me qira

KONTRATE PËR SHFRYTËZIMIN E PAJISJEVE ME QERA

Në mes:

Kompanisë:

BESIM A.ZEJNULLAHU B.I.

Nr.Unik identifikues: 810668428

Adresa: Rr.Reqakut, Ferizaj me përfaqësues

Besim Zejnullahu

dhe

Kompanisë:

VLORA A.AHMETI B.I

Nr.Unik identifikues: 811276973

Adresa: Barilevë, Prishtinë me përfaqësues Vlora Ahmeti

Lënda e kontratës: Dhënia me qira e Pajisjeve

Kjo kontratë paraqet marrëveshjen në mes të kompanisë **BESIM A.ZEJNULLAHU B.I.** dhe kompanisë **VLORA A.AHMETI B.I.**, ku këto dy palë janë dakorduar që kompania **VLORA A.AHMETI B.I** do të mbështet kompaninë **BESIM A.ZEJNULLAHU B.I** duke ja dhënë në shfrytëzim Pajisjet për realizimin e projektit në Komunën e Obiliqit me titull: **Dezinfektim, Deratizim, Dezinfektim në Institucione Publike Komunale**, dhe me numer të prokurimit: **614-26-3929-2-2-1**.

Emri i pajisjeve të cilat jepen me qira janë si në vijim:

1. Automizer multifunksional elektrostatische per dezinfektim hapsinore (1 copë)

Tarifa për pajisje do të jetë 50 Eur për 24 orë në shfrytëzim, pagesa do të behet nga data 1-05 të muajit pasardhës, në bazë të faturave të pranuar.

Kjo kontratë do të jetë aktive nga data e nënshkrimit deri në realizimin e projektit të lartëpërmendur.

Në rast të mos mundësisë për zgjidhjen e ndonjë mosmarrëveshjeje në mes të dy palëve nënshkruese të kësaj kontrate, palët në fjalë kanë të drejtë të bëjnë ankesa apo të ngjashme në gjykatat kompetente të vendit apo përmbauesve privat.

Besim A.Zejnullahu B.I - N.SH." EKO-DDD

Përfaqësues: Besim Zejnullahu

VLORA A.AHMETI B.I

Përfaqësues: Vlora Ahmeti

Nënshkrimi:

Nënshkrimi:



Data: 15.06.2026



Nga kontrata për shfrytëzimin e pajisjes me qira, e lidhur ndërmjet Besim A. Zejnullahu B.I. dhe Vlora A. Ahmeti B.I., rezulton se lënda e qirasë është vetëm pajisja "Automizer multifunksional elektrostatische për dezinfektim hapësinor (1 copë)". Edhe në këtë kontratë nuk dëshmohet se pajisja është gjenerator ULV, nuk jepet model teknik, nuk jepet katalog, nuk jepen specifika teknike, nuk jepet kapaciteti i pajisjes, mënyra e punës, madhësia e piklave, sistemi i mjegullimit të ftohtë, apo ndonjë karakteristikë tjetër që do të vërtetonte se pajisja i përmbush kërkesat për gjenerator ULV.

SAMIRE OSMANI B.I

NUI : 811044247

Brigada 123, Suharekë, 23000, Kosovë; Tel: 044 880 990

Xhirrlogarit: 1705001012695728 N.I.B

FATURË TATIMORE / INVOICE		Blerësi:	VLORA A. AHMETI B.I
Nr.Fakt.	09-03/19	NUI	811276973
Data:	26.03.2019	Adresa:	BARILEVE ,PRISHTINE

Verejtje : Pagesa brenda 15 ditëve

Nr.	Emërtimi i Shërbimit	Nj.	Sasia	Cmimi/njësi	Vlera totale
-----	----------------------	-----	-------	-------------	--------------

1 Automizer multifunksional
elektrostatike per
dezinsektim hapësirave

cope

1.00

4,900.00

4,900.00

2 Pompe elektrike per
sperkatje ULV

cope

4.00

2,000.00

500.00

3 Pompe per sperkatje
me benzin

cope

4.00

600.00

150.00

4 Fumigator

cope

1.00

1,100.00

1100.00

Vlera e Faktures pa TVSH

8600.00

Vlera Totale për Pagesë

8,600.00 €

Pagesa permes Bankes

Fakturoi: 50




Si dëshmi për këtë pajisje është dorëzuar një faturë tatimore e lëshuar nga Samire Osmani B.I., ku si blerës figuron Vlora A. Ahmeti B.I.. Në këtë faturë, pajisja është e shënuar si “Automizer multifunksional elektrostatische për dezinfektim hapësirave”, me vlerë 4,900.00 €. Edhe në këtë dokument nuk figuron emërtimi “Gjenerator ULV”, nuk figuron model teknik i pajisjes, nuk figuron numër serik, katalog, manual apo specifikacion teknik që do të dëshmonte se pajisja është realisht gjenerator ULV.


Për më tepër, fatura e paraqitur nuk është e nënshkruar nga blerësi/pranuesi i mallit dhe nuk është bashkëngjitur asnjë dëshmi mbi pagesën bankare të kësaj fature, edhe pse në faturë theksohet “pagesa përmes bankës”. Mungesa e dëshmisë së pagesës, mungesa e nënshkrimit/pranimit nga blerësi dhe mungesa e të dhënave teknike të pajisjes e bëjnë këtë dëshmi të pamjaftueshme për të vërtetuar pronësinë dhe natyrën reale të pajisjes së paraqitur.

Në këtë rast kemi një mospërputhje të qartë ndërmjet emërimit të pajisjes në listën e mjeteve dhe dokumenteve mbështetëse të saj. Në listë pajisja është paraqitur si “Gjenerator ULV – Automizer...”, ndërsa në faturë dhe në kontratën e qirasë ajo figuron vetëm si “Automizer multifunksional elektrostatik për dezinfektim hapësirave”. Pra, termi “Gjenerator ULV” duket të jetë shtuar në listë vetëm për ta përshtatur formalisht pajisjen me kërkesën e Dosjes së Tenderit, pa u dëshmuar realisht se pajisja është e tillë.

Dëshmia nr. 5 – Screenshot nga kërkimet/krahasimet teknike për këtë lloj pajisjeje



Dëshmia nr. 5.2 – Screenshot nga kërkimet/krahasimet teknike për këtë lloj pajisjeje



Nga krahasimet dhe të dhënat publike për këtë lloj pajisjeje, rezulton se pajisja “Automizer multifunksional elektrostatik” nuk është e njëjtë me një gjenerator ULV profesional të kërkuar për trajtime hapësinore. Një pajisje elektrostатike/automizer nuk mund të barazohet automatikisht me gjenerator ULV, sidomos kur OE nuk ka dorëzuar asnjë katalog, manual, certifikatë teknike apo dokument të prodhuesit që dëshmon se pajisja krijon mjegull të ftohtë ULV dhe funksionon sipas parametrave të kërkuar për dezinfektim hapësinor.

Dyshimet janë edhe më të theksuara për shkak të vlerës së paraqitur në faturë. Pajisja është faturuar në shumën prej 4,900.00 €, ndërsa nga kërkimet dhe krahasimet e tregut për pajisje të ngjashme rezulton dyshim i arsyeshëm se vlera e paraqitur mund të jetë e fryrë dhe jo reale për këtë lloj pajisjeje. Kjo çështje kërkon verifikim të veçantë nga Autoriteti

Kontraktues, pasi një faturë me vlerë të dyshimtë dhe pa dëshmi pagese nuk mund të merret automatikisht si dëshmi e mjaftueshme për pajisje profesionale të nivelit të kërkuar në DT.

Edhe nëse kontrata e qirasë do të pranohej nga ana formale, ajo nuk e shndërron një pajisje “Automizer multifunksional elektrostatik” në “Gjenerator ULV”. Marrëveshja e qirasë dëshmon vetëm që palët kanë lidhur një kontratë për përdorimin e një pajisjeje të caktuar, por nuk dëshmon se pajisja e marrë me qira i plotëson karakteristikat teknike të kërkuara nga Dosja e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të verifikojë jo vetëm ekzistencën formale të një fature apo kontrate qiraje, por edhe përputhshmërinë reale të pajisjes me kërkesën e vendosur në Dosjen e Tenderit. Në këtë rast, AK ka pranuar një pajisje me emërtim të paqartë dhe me dokumentacion jo të mjaftueshëm, duke e konsideruar si gjenerator ULV pa pasur dëshmi objektive se pajisja është realisht e tillë.

Për këtë arsye, oferta e OE-së së rekomanduar nuk e plotëson kërkesën për pajisjet e nevojshme, konkretisht kërkesën për gjenerator ULV. Pranimi i kësaj pajisjeje si të barasvlershme me gjenerator ULV përbën vlerësim të gabuar, trajtim jo të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe cenim të kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Qëndrimi i Autoritetit Kontraktues dhe kundërshtimi i OE ankues lidhur me Pretendimin nr. 2

Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen e tij ndaj Pretendimit nr. 2, ka arsyetuar se OE i rekomanduar për kontratë ka përmbushur kërkesën për pajisjet e nevojshme, pasi ka dorëzuar listën e pajisjeve dhe dokumentacionin përkatës për pronësinë ose disponueshmërinë e tyre. AK ka vlerësuar gjithashtu se katalogu, manuali, specifikimet teknike, dëshmia e pagesës apo dokumente të tjera të ngjashme nuk kanë qenë të kërkuara shprehimisht në Dosjen e Tenderit dhe, për këtë arsye, mungesa e tyre nuk mund të përdoret si bazë për shpalljen e ofertës si të papërgjegjshme.

Sipas këtij arsyetimi, AK e ka konsideruar të mjaftueshëm faktin se në listën e pajisjeve është shënuar pajisja e kërkuar dhe se OE i rekomanduar ka paraqitur dokumente që, sipas AK-së, dëshmojnë disponueshmërinë e saj. Megjithatë, kjo përgjigje nuk e trajton çështjen thelbësore të ngritur nga ana jonë, përkatësisht nëse pajisja e paraqitur dhe e dëshmuar në dokumentacionin mbështetës është realisht e njëjta pajisje me atë të kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Për rrjedhojë, ndaj arsyetimit të Autoritetit Kontraktues paraqesim kundërshtimin në vijim:

Kundërshtim ndaj përgjigjes së Autoritetit Kontraktues lidhur me Pretendimin nr. 2 Mospërmbushja e kërkesës për dy gjeneratorë ULV

Përgjigjja e Autoritetit Kontraktues ndaj Pretendimit nr. 2 është deklarative, e paargumentuar dhe nuk mbështetet në përmbajtjen reale të dokumenteve të dorëzuara nga OE i rekomanduar. AK-ja është mjaftuar me konstatimin e përgjithshëm se kërkesa për dy gjeneratorë ULV është përmbushur përmes listës së pajisjeve dhe dokumentacionit mbështetës, pa identifikuar asnjë dokument konkret që provon se pajisja e dytë është, në të vërtetë, **gjenerator ULV**.

Thelbi i pretendimit tonë nuk është mungesa formale e katalogut, manualit apo dëshmisë së pagesës. Çështja vendimtare është se dokumentet e dorëzuara nga vetë OE i rekomanduar

nuk dëshmojnë pajisjen e kërkuar nga Dosja e Tenderit. Prandaj, referimi i AK-së në faktin se dokumente të tilla nuk janë kërkuar shprehimisht është i parëndësishëm dhe e shmang çështjen kryesore: **a është pajisja e paraqitur gjenerator ULV apo është një pajisje tjetër?**

Dosja e Tenderit nuk ka kërkuar në mënyrë të përgjithshme një pajisje për spërkatje apo dezinfektim. Ajo ka kërkuar shprehimisht **dy (2) gjeneratorë ULV**, ndërsa në specifikimet teknike ka përcaktuar se pajisja ULV duhet të jetë gjenerator që punon me insekticid të tretshëm në ujë dhe krijon mjegull të ftohtë, përfshirë një gjenerator të madh për kamion dhe së paku një gjenerator të vogël të dorës. Pra, natyra dhe funksioni i pajisjes janë përcaktuar qartë dhe nuk mund të zëvendësohen me një pajisje tjetër vetëm për shkak se ajo përdoret në fushën e dezinfektimit.

OE i rekomanduar, në listën e mjeteve të punës, ka përdorur emërtimin:

- “Gjenerator ULV – Automizer multifunksional elektrostatik për dezinfektim hapësinor.”

Ky formulim është një deklaram i njëanshëm i OE-së dhe nuk përbën provë teknike se automizeri është gjenerator ULV. Vendosija e termit “Gjenerator ULV” para emërimit real të pajisjes nuk ia ndryshon pajisjes natyrën, konstruksionin, mënyrën e funksionimit apo karakteristikat teknike. Në procedurat e prokurimit, përputhshmëria nuk dëshmohej përmes emërimit që operatori zgjedh ta shkruajë në listë, por përmes dokumenteve objektive që identifikojnë pajisjen e deklaruar.

Pikërisht këtu qëndron mospërputhja që AK-ja ka dështuar ta trajtojë. **Dëshmia nr. 3 – Kontrata për shfrytëzimin e pajisjes me qira** e identifikon objektin e qirasë vetëm si:

- “Automizer multifunksional elektrostatik për dezinfektim hapësinor – 1 copë.”

Kontrata nuk e identifikon pajisjen si gjenerator ULV, nuk përmban prodhues, model, numër serik apo të dhëna që tregojnë se pajisja krijon mjegull të ftohtë sipas sistemit ULV. Për pasojë, kjo kontratë dëshmon vetëm disponueshmërinë e një automizeri multifunksional elektrostatik dhe jo disponueshmërinë e gjeneratorit të dytë ULV.

E njëjta gjendje vërtetohet edhe përmes **Dëshmisë nr. 4 – Faturës së blerjes**, ku pajisja figuron përsëri vetëm si:

- “Automizer multifunksional elektrostatik për dezinfektim hapësinor.”

Pra, edhe dokumenti mbi të cilin pretendohet pronësia e qiradhënësit nuk e njeh pajisjen si gjenerator ULV. Kur fatura dhe kontrata e qirasë e identifikojnë pajisjen si automizer multifunksional elektrostatik, AK-ja nuk mund ta riklasifikojë atë si gjenerator ULV vetëm mbi bazën e listës së përgatitur nga OE i rekomanduar.

Një automizer multifunksional elektrostatik nuk mund të pranohet automatikisht si gjenerator ULV, sepse këto emërime u referohen funksioneve dhe teknologjive të ndryshme. Funksioni elektrostatik lidhet me ngarkimin elektrik dhe depozitimin e piklave në sipërfaqe, ndërsa gjeneratori ULV duhet të prodhojë dhe shpërndajë mjegull të ftohtë me volum jashtëzakonisht të ulët, sipas parametrave teknikë të përcaktuar për trajtim hapësinor.

Fakti se të dyja pajisjet mund të përdoren për aplikimin e preparateve nuk i bën ato teknikisht të njëjta apo të këmbyeshme.

Dëshmia nr. 5 – Screenshot-et nga kërkimet dhe krahasimet teknike është paraqitur për të dëshmuar pikërisht këtë dallim dhe për të treguar se një automizer elektrostatik nuk mund të barazohet vetëm në bazë të emërimit me një gjenerator profesional ULV. Në mungesë të çdo dokumenti të prodhuesit që do të provonte për pajisjen konkrete funksionin ULV, aftësinë për krijimin e mjegullës së ftohtë, madhësinë e piklave dhe parametrat e kërkuar, pajisja duhet të vlerësohet sipas emërimit dhe dokumentacionit që realisht e shoqëron: **automizer multifunksional elektrostatik**, dhe jo gjenerator ULV.

Prandaj, arsyetimi i AK-së se katalogët ose manualët nuk janë kërkuar në Dosjen e Tenderit nuk e shpëton ofertën nga papërgjegjshmëria. OE i rekomanduar nuk eliminohet për shkak se nuk ka dorëzuar katalog; ai duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm sepse dokumentet që ka dorëzuar **nuk dëshmojnë përmbushjen e kërkesës për dy gjeneratorë ULV**. Mungesa e katalogut vetëm e bën të pamundur që deklarimi i njëanshëm në listë të verifikohet dhe të tejkalohet përmbajtjen e kundërt të faturës dhe kontratës së qirasë.

AK-ja ka bërë një gabim thelbësor juridik duke barazuar **disponueshmërinë e një pajisjeje me përputhshmërinë e saj me kërkesën teknike**. Kontrata e qirasë mund të dëshmojë se OE-ja ka në dispozicion një automizer, por nuk dëshmon se automizeri është gjenerator ULV. Disponueshmëria e pajisjes së gabuar nuk përmbush kërkesën për pajisjen e kërkuar.

Nëse do të pranohej që një operator mund ta përmbushë kriterin vetëm duke ia **shtuar** pajisjes në listë emërtimin e kërkuar, atëherë kriteret teknike të Dosjes së Tenderit do të humbnin çdo efekt juridik dhe verifikues. Me të njëjtën logjikë, çdo spërkatëse, pompë ose automizer mund të deklarohej “gjenerator ULV”, pa qenë e nevojshme të dëshmohej natyra e saj reale. Një qasje e tillë cenon drejtpërdrejt parimin e vlerësimit objektiv dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Përfundimisht, dokumentacioni i OE-së së rekomanduar dëshmon një gjenerator ULV të identifikuar si “MMT Hunter Mist Blower 35HP” dhe një pajisje tjetër të identifikuar në faturë dhe në kontratën e qirasë si “Automizer multifunksional elektrostatik”. Rrjedhimisht, OE-ja nuk ka dëshmuar dy gjeneratorë ULV, por vetëm një të tillë. Konstatimi i AK-së se kërkesa është përmbushur nuk mbështetet në asnjë provë teknike dhe është në kundërshtim me vetë përmbajtjen e dokumenteve të ofertës.

Për këto arsye, përgjigjja e AK-së ndaj Pretendimit nr. 2 duhet të refuzohet si e pabazuar, ndërsa oferta e OE-së së rekomanduar nuk mund të konsiderohet teknikisht e përgjegjshme, sepse pajisja e paraqitur si automizer multifunksional elektrostatik nuk e përmbush dhe nuk e zëvendëson kërkesën e qartë për gjenerator ULV.

PËRFUNDIM

Duke u bazuar në pretendimet, faktet, dëshmitë dhe argumentet e paraqitura në këtë ankesë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues – **Kuvendi Komunal i Obiliqit**, gjatë vlerësimit të ofertave dhe shqyrtimit të kërkesës sonë për rishqyrtim, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, Rregullores për Prokurimin Publik dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit për aktivitetin e prokurimit **“Dezinfektim, Deratizim,**

Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë ekzaminim përmbajtësor dhe objektiv të kapacitetit teknik dhe profesional të OE-së së rekomanduar për kontratë, por është mjaftuar me ekzistencën formale të dokumenteve dhe me deklaratimet e njëanshme të bëra nga vetë operatori ekonomik. Në këtë mënyrë, AK-ja ka konsideruar se kërkesat janë përmbushur vetëm sepse është dorëzuar një dokument i titulluar “Lista e stafit” dhe një listë e pajisjeve, pa verifikuar nëse përmbajtja e këtyre dokumenteve dëshmon realisht kapacitetet e kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Andaj, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që:

- Ta aprovojë ankesën e Operatorit Ekonomik ankues **Best D.D.D. SH.P.K.** si plotësisht të bazuar;
- T’i konsiderojë të bazuara pretendimet e paraqitura në këtë ankesë;
- Ta anulojë Vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim;
- Ta anulojë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – B58, përmes të cilit OE **Besim A. Zejnullahu B.I.** është rekomanduar për dhënie të kontratës;
- Të konstatojë se OE i rekomanduar nuk ka dëshmuar përmbushjen e plotë të kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional të përcaktuara në Dosjen e Tenderit;
- Të konstatojë se dokumentet e dorëzuara nga OE i rekomanduar nuk ofrojnë dëshmi të mjaftueshme, objektive dhe të verifikueshme për përmbushjen e kërkesave të kontestuara;
- Të konstatojë se një pajisje e dokumentuar si “**Automizer multifunksional elektrostatik**” nuk mund të pranohet si “**Gjenerator ULV**” vetëm mbi bazën e emërimit të vendosur në listën e pajisjeve, pa prova teknike dhe dokumentare që vërtetojnë se pajisja konkrete i plotëson karakteristikat dhe funksionet e kërkuara;
- Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që aktivitetin e prokurimit ta kthejë në rivlerësim të plotë, objektiv dhe të ligjshëm;
- Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit ta trajtojë ofertën e OE-së së rekomanduar në përputhje me kërkesat materiale të Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e LPP-së;
- Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që ofertën e OE-së së rekomanduar ta shpallë të papërgjegjshme, për shkak të mosdëshmimit të përmbushjes së kërkesave të detyrueshme të Dosjes së Tenderit;
- Të mos lejojë plotësimin apo ndryshimin material të ofertës pas afatit për dorëzimin e tenderëve, përmes paraqitjes së personelit të ri, pajisjeve të reja apo dokumenteve që do të krijojnë pas afatit kapacitete të cilat nuk janë dëshmuar në ofertën fillestare;
- Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që oferta e OE ankues **Best D.D.D. SH.P.K.** të rivlerësohet në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe përmbajtësore, pa aplikimin e kriterëve të papublikuara dhe pa standarde të ndryshme të vlerësimit;
- Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që, pas rivlerësimit, të vazhdojë procedurën me operatorin ekonomik të përgjegjshëm që plotëson të gjitha kërkesat dhe ka paraqitur çmimin më të ulët, në përputhje me kriterin e dhënies së kontratës.

Kjo kërkesë paraqitet me qëllim që aktiviteti i prokurimit të zhvillohet në përputhje të plotë me parimet e ligjshmërisë, transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës së drejtë dhe mbrojtjes së interesit publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Eliminim i pabazuar i ofertës.

Humbje e mundësisë për kontratë.

Trajtim i pabarabartë në vlerësim.

Cenim i konkurrencës së ndershme.

Shpenzime për përgatitje të ofertës që kapin vlerën prej 300 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.